



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË

PROCESVERBAL  
KËSHILLI I GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, më 07.07.2021

Me datë 07.07.2020, me kërkesën dhe nën drejtimin e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

1. Vijimi i procedurës për plotësimin e vendit vakant, Kryesekretar në Gjykatën e Lartë, e pezulluar me vendim të Këshillit të Gjykatës, datë 01.04.2021.
2. Rishpallja e vendeve vakante për Sekretarë Gjyqësor, dy vende dhe Specialiste në Qendrën e dokumentacionit dy vende.
3. Të ndryshme, të cilat janë disa materiale të paraqitura nga Drejtoria e Burimeve njerëzore, me shpjegime dhe një material tjetër që ka të bëjë me një saktësim të një vendimmarrje tonë, përsa i përket relatimit të çështjeve dhe shortit për vijimësinë e atyre çështjeve, të cilat janë filluar me trupa të mëparshëm dhe që së shpejti pritet të zëvendësohet me trupa të tjerë gjyqtarësh.

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

- |                  |   |
|------------------|---|
| 1. Sokol SADUSHI | Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë            |
| 1. Ilir PANDA    | Anëtar Gjykatës së Lartë                  |
| 2. Kelmend GRECA | Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor |

Të pranishëm në mbledhje e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) A. V., me detyrë Drejtore e Kabinetit të Kryetarit
- 2) M.K., me detyrë këshilltar i Kabinetit të Kryetarit
- 3) B. A., sekretare gjyqësore, e ngarkuar për të mbajtur dhe zbardhur proces verbalin audio të mbledhjes.

Në fjalën hyrëse, Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës.

Lidhur me çështjen e parë të rendit të ditës që kishte të bënte me vijimin e procedurës së plotësimit të vendit vakant për Kryesekretar, Kryetari i Këshillit z. Sokol Sadushi sqaroi se si rezultat i ndryshimi të vendimit të Këshillit të Ministrave, niveli i pagës për këtë pozicion kishte ndryshuar në kategorinë III-a dhe për këtë arsye procedura e rekrutimit të kandidatës T.N. në pozicionin e kryesekretares ishte pezulluar me qëllim për ti bërë me dije kandidatës se niveli i pagës që pretendohej të merrte si kryesekretare në pozicionin e Drejtorit të Kryesekretarit, ishte i njëjtë me atë nivel page që ajo merrte dhe për ti dhënë mundësinë për të dëgjuar opinionin e saj lidhur me vazhdimin e konkurrencës, në kushtet e ndryshimit të situatës ligjore.

Këshilli gjatë intervistës dëgjoi opinionin e kandidatës, e cila shprehu interesin që ta vazhdojë më tej konkurrimin për kryesekretare pavarësisht ndryshimit kategorisë së pagës.

Në përfundim të intervistës, Këshilli nisur nga fakti se kandidatja T.N. i plotësonte të gjitha kushtet për pozicionin e kryesekretares, vendosi në mënyrë unanime emërimin definitiv të saj si Kryesekretare e Gjykatës së Lartë.

Çështja e dytë e rendit të ditës që kishte të bënte me rishpalljen e vendeve vakante për sekretarë gjyqësor, dy vende dhe specialiste në Qendrën e Dokumentacionit dy vende. Kryetari i Këshillit vuri në dijeni Këshillin se bazuar në shpalljet për procedurën e pranimit për këto vende vakante, ka rezultuar që kandidatët i plotësojnë kushtet, por sugjerohet nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore se për sa kohë që numri i kandidatëve është i ulët dhe për ti dhënë mundësi gjykatës dhe Këshillit për të pasur një hapësirë vlerësimi me kandidatura me të përshtatshme dhe me cilësore që mund të paraqiten, të shihet mundësia e rihapjes së procedurës, duke kërkuar opinionin e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit për këtë propozim.

Anëtarët e tjerë në diskutimin e tyre ranë në parim dakort me propozimin për rihapjen e procedurës së pranimit për kandidatë të rinj, por ku të përfshihen edhe kandidatët që kanë aplikuar më parë.

Në përfundim, Këshilli ra dakort për rishpalljen e vendeve vakantë, për sekretarë gjyqësorë 2 vende dhe për në Qendrën e Dokumentacionit 2 vende, si dhe përfshirjen në proces të kandidatëve që kanë aplikuar tashmë si dhe të kandidatëve të tjerë që do të aplikojnë në vijimësi .

Tek pika e rendit të ditës “*Të ndryshme*” Kryetari i Këshillit sqaroi nevojën për një saktësim që duhet të bëhet në vendimmarrjen e mëparshme të Këshillit lidhur me vazhdimin e gjyqimit të çështjeve nga trupa gjyqësore e caktuar për shqyrtim në dhomë këshillimi. Me ardhjen e gjyqtarëve të rinj në Kolegjin Penal u rishqyrtuan dhe një herë të gjitha çështjet penale, për të cilat ishte caktuar relator një gjyqtar i vetëm, që ishte gjyqtar Ilir Panda, mbi bazën e rregullit të vendosur më parë nga gjykata që Kolegji, i cili kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, do të ishte po ai që do ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore.

Së shpejti pritet të vijnë në Trupën gjyqësore nga një gjyqtar në Kolegjin Civil dhe në Kolegjin Administrativ, ku në secilin prej tyre aktualisht ka vetëm një gjyqtar relator. Pra, propozimi është që të gjitha çështjet për të cilat Kolegji Civil apo Administrativ, njësoj si Kolegji Penal, të mos shortohen, por të ngelen dhe përfundohen me atë relator dhe me atë trup

grykues, që kanë vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa të gjitha çështjet e tjera të rishortohen.

Anëtarët e tjerë të Këshillit u shprehën dakort për këtë propozim dhe kjo pikë e rendit të ditës u miratua në mënyrë unanime.

Çështja e fundit e rendit kishte të bënte me një material të përgatitur nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe e Shërbimeve mbi caktimin e limitit të karburantit për automjetet në dispozicion të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, duke ftuar për këtë qëllim në mbledhje drejtorin z. F.M.

Drejtori sqaroi situatën në të cilën ndodhej problemi i transportit i gjyqtarëve si dhe planifikimin mesatar për karburant, duke u bazuar në një testim të konsumit të karburantit si dhe duke konsultuar, për analogji, dhe normativat që përdor Këshilli i Lartë Gjyqësor për këtë qëllim. Sipas këtyre faktorëve, dolën rezultate që pak a shumë janë në limitet e rreth 150 litra për një muaj dhe mbi këtë bazë propozohet që ky të jetë limiti i karburantit për çdo gjyqtar. Anëtarët e Këshillit vijuan debatin me komente lidhur me metodologjinë e përdorur për përcaktimin e limitit të karburantit, sasinë optimale që duhet të ketë në dispozicion gjyqtari nisur nga faktorë të ndryshëm (gjatësia e rrugës, nevoja për lëvizje, vjetërsia dhe modeli i makinës, koha e pikut të lëvizjeve etj).

Me qëllim gjetjen e një zgjidhje optimale, mbi bazën e propozimit të anëtarit të Këshillit z. Kelment Greca, Këshilli ra dakort që administratës së Gjykatës së Lartë t'i lihet kohë për të bërë një vlerësim tjetër më objektiv lidhur me sasinë karburantit që do të kenë në dispozicion gjyqtarët.

Gjithashtu, në fund të mbledhjes, anëtarit të Këshillit z. Ilir Panda, duke përfituar nga fakti se si anëtar i Këshillit ishte dhe përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë z. Kelment Greca, kërkoi që ky i fundit t'i transmetojë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për mundësinë e përshpejtimit të procedurës së emërimit të këshilltarëve ligjorë në Gjykatën e Lartë, kërkesë e cila u mbështet plotësisht dhe nga Kryetari i Këshillit z. Sokol Sadushi.